



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:106115

Datë: 12.12.2023

Numri i dokumentit: 05050205

C-III-19-0074

Paditësit

1. L V, Lipjan.
2. S D, Lipjan.
3. F A, Graçanicë

Të përfaqësuar nga avokat E P nga Vitia.

Kundër

Të Paditurat:

1. **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Agim Ramadani" nr.23, Prishtinë.
2. **Kuvendi Komunal-Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi Graçanicë, Prishtinë.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, kolegji i përbërë nga gjyqtarja Hajrie Shala, kryesuese e kolegjit dhe gjyqtarët Djellza Hoxha dhe Asllan Krasniqi, anëtarë të kolegjit, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 12 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. Hedhet poshtë si i papranueshëm propozimi për aktivizim e propozimit për të masës së sigurisë, të dt. 11.04.2019 .
2. Nuk caktohet taksa gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 17 tetor 2013, paditësit parashtruan padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (tutje DHPGJS), kundër të paditurave. Paditësit kërkojnë nga Gjykata që të vërtetohet se ata kanë fituar të drejtën pronësore në ngastrat kadastrale, nr. ...në vendin e quajtur “B” në sipërfaqe prej 0.25,10 ha, ZK “L P”, nr. ...në vendin e quajtur “Z – k v” në sipërfaqe prej 0.36,94 ha, ZK “L P”, nr... në vendin e quajtur “V”, në sipërfaqe prej 0.21,57 ha, ZK Prishtinë. Njohjen e së drejtës se pronësisë paditësit e kërkojnë mbi bazën e aktgjykimit P.br.1908/2003 të datës 19 dhjetor 2006, i plotfuqishëm me 23 korrik 2007.

Më 30 korrik 2015, e paditura e parë AKP-ja, ka parashtruar mbrojtje në padi, në të cilën e kundërshton padinë dhe pretendimet e paditësve si të pa bazuara, duke pohuar se paditësit nuk e kanë theksuar bazën juridike në të cilën e mbështesin kërkesëpadinë dhe se nga kjo rrjedh se padia është parashtruar në kundërshtim me nenin 27.2.4 të Shtojcës së ligjit për DHPGJS si dhe në kundërshtim me nenin 253 të LPK-së. E paditura ka propozuar që të hedhet poshtë padia si e pa pranueshme ose të refuzohet si e pa bazuar në ligj.

Me Aktvendimin e Kolegji të Specializuar C-III-13-0495, të datës 27 dhjetor 2017, është konfirmuar se Aktgjykimi i formës së prerë i lëshuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë P.br.1908/03 i datës 19 dhjetor 2006, është përfundimtar.

Më 10 janar 2018, e paditura AKP-ja ka parashtruar ankesë kundër aktvendimit C-III-13-0495 të datës 27 dhjetor 2017, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, aktvendimi i atakuat të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, apo i njëjti të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pabazuar. AKP ankesës i ka bashkangjitur si provë të re një vendim gjyqësor të nxjerr në një çështje penale PAKR 158/15 të datës 05 prill 2016, të cilin nuk e kishte paraqitur në kolegjin e specializuar. Më 22 janar 2018 e paditura ka bërë plotësimin e ankesës.

Më 11 prill 2019, paditësi A F ka parashtruar kërkesë për lëshimin e urdhrin paraprak gjyqësor/masës së sigurimit, në të cilën ka propozuar që AKP-së ti ndalohet që të bëjë tjetërsimin apo në çfarëdo mënyre ti ngarkojë ngastrat kadastrale nr..., në vendin e quajtur “B” në sip. 0.25,10 ha, nr..., në vendin e quajtur “Z k v”, në sipërfaqe prej 0,6.94 ha, të dyja parcelat në ZK Ll S dhe ngastra kadastrale nr..., në vendin e quajtur “V”, në sipërfaqe prej 0.21,57 ha, ZK Prishtinë. Paditësi ka pohuar se AKP-ja me 08 maj 2019 ka shpallur tender për shitjen me ofertë të mbyllur të parcelave që janë subjekt i aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P.br. 1908/03 i datës 19 dhjetor 2006. Po ashtu, sipas

paditësit po të ishte shpallur tenderi dhe po të ishte realizuar shitja e parcelave në fjalë, paditësit do të kishin pësuar dëme të pa riparueshme sepse, në këtë mënyre ata do të mbeteshin pa pronën e tyre, të cilën e kishin fituar në bazë të një aktgjykimi të plotfuqishëm, e i cili nuk mund të ndryshohet në asnjë mënyrë.

Më 30 prill 2019, paditësi A F ka parashtruar përgjigje në ankesën e AKP-së, në të cilën ka pohuar se ankesa nuk është e bazuar dhe se nuk janë shkelur dispozitat e procedurës kontestimore, pasi që gjykata nuk kishte nevojë të caktonte seance përgatitore ose seancë kryesore, sepse gjykata mund të vendoste pa mbajtur fare seancë.

Kolegji i Apelit, me Aktvendimin AC-I-18-0013 të datës 11 korrik 2019, ka aprovuar ankesën e AKP-së si të bazuar, ka anuluar aktvendimin e Kolegjit të Specializuar i DHPGJS C-III-13-0495 i datës 27 dhjetor 2017, lënda është kthyer në rigjykim në Kolegjin e shkallës së parë dhe kërkesa e paditësve për masë të përkohshme është dërguar në shkallë të parë për vendosje. Në këtë rast pas kthimit të çështjes në shkallë të parë për rivendosje, lënda ka marr numër të ri C-III-19-0074.

Më 19 korrik 2019, e paditura AKP-ja, duke u përgjigjur në urdhërin e datës 17 korrik 2019, e ka njoftuar gjykatën se tri ngastrat kadastrale që janë objekt kontesti në këtë çështje, janë pezulluar nga shitja në likuidim të valës 46 dhe se lidhur me këto ngastra (nr...., .. dhe ...), AKP-ja nuk do të ndërmerr asnjë veprim për shitjen e tyre, deri në vendosjen e çështjes përfundimisht.

Me dt. 11.09.2019 gjykata mori vendim lidhur me propozimin e paditësve për caktimin e Masës së përkohëshme, duke e refuzuar të njëjtën si të pabazuar.

Më 05 janar 2022, përfaqësuesi i paditësve ka dorëzuar një parashtrësë plotësuese me të cilin ka dorëzuar kopjen e Aktvendimit për pranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese me nr.ref: RK578/14.

Gjykata ka ndërmarr të gjitha veprimet procedurale në kuptim të kompletimit të lëndës e pastaj ka caktuar dhe mbajtur seancën përgatitore dhe ate të shqyrtimit gjyqësor për shqyrtimin e çështjes kontestimore.

Në seancën vendimmarrëse të dt. 08.05.2023 gjykata ka marr aktvendim për pezullim të procedurës në çështjen juridike të paditësve, deri në vendosjen e propozimit të të paditurës AKP, për përsëritje të procedurës, në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Përfaqësuesi i paditësve Av. E P me dt. 18.10.2023 ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme një parashtrësë me të cilën ka kërkuar aktivizimin e propozimit për lëshimin e masës së sigurisë të parashtruar me dt. 11.04.2019.

Me dt 07.11.2023 e paditura është përgjegjur në urdhërin e gjykatës ku ka theksuar se në parashtrësën e paditësve shihet qartë se nuk janë plotësuar kushtet ligjore në bazë të nenit 61 të ligjit të Dhomës së Posaçme andaj, i ka propozuar gjykatës që propozimi i paditësit të refuzohet si i pabazuar.

Për detaje tjera referim behet tek dosja e lëndës.

Arsyetimi ligjor

Kërkesa për aktivizim të propozimit për masë të sigurimit hedhet poshtë si e papranueshme

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Me dt. 11.09.2019 Gjykata ka marr vendim me të cilin ka refuzuar kërkesën për masë të sigurisë, si të pabazuar .

Kurse, me dt. 18.10.2023 përfaqësuesi i paditësve Av. E P ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme një parashtrësë me të cilën ka kërkuar aktivizimin e propozimit për lëshimin e masës së sigurisë të parashtruar me dt. 11.04.2019 .

Lidhur me propozimin për masë të sigurisë të dt. 11.04.2019 të cilit i referohet përfaqësuesi, Gjykata ka vendos me aktvendimin e dt. 11.09.2019 dhe në analizim të Ligji të Dhomës së Posaçme nuk ka asnjë dispozitë e cila parashih një kërkesë të tillë të ashtu quajtur nga përfaqësuesi “aktivizim të kërkesës” .

Paditësit, ka mund të paraqes kërkesë të re për lëshimin e masës së sigurimit, gjithë herë duke përmbush kriteret që parashihen me nenin 61 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe kur paditësi konsideron se ka rrezik se e paditura me veprime konkrete tenton ti tjetërsoj apo ti shes parcelat të cilat janë objekt i kontestit, por jo të kërkoj aktivizim të kërkesës për të cilën Gjykata ka vendosur me aktvendim .

Nga arsyet e theksuara Gjykata gjeti se propozimi i paditësit duhet të hedhet poshtë për shkak të papranueshmërisë.

Shpenzimet Gjyqësore

Nuk caktohen taksa gjyqësore për paditësit .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme Brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hajrie Shala, Gjyqtare kryesuese

Djellza Hoxha , Gjyqtare

Asllan Krasniqi, Gjyqtar